



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 106 prot.

Kamëz, më 19.07.2022

V E N D I M

Nr. 90 Datë 19/07 2022

MBI

“MIRATIMIN NË PARIM TË SHTYRJES SË AFATIT PËR NJË PERIUDHË NJË VJEÇARE TË DHËNIES ME QIRA TË AMBIENTEVE BRENDA PALLATIT TË KULTURËS TË LLOJIT “NDËRTESE” ME SIPËRFAQE 165 m², NË PRONËSI TË BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.07.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.78 Datë 15.07.2022 në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2 shkronja “c”, nenit 54, shkronja “c” dhe nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/ 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 28, pika 2, të Ligjit nr. 44/ 2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Vendimin nr. 775, datë 05.09.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz”; Kreut II, të Vendimit nr. 54 datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar; Udhëzimit nr. 13, datë 26.04.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar; **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të dhënies me qira të ambienteve brenda pallatit të Kulturës të llojit “ndërtesë”, me sipërfaqe 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) m², me zonë kadastrale nr. 2066, me nr. pasurie 92/ 30 në pronësi të Bashkisë Kamëz, sipas Vendimit nr. 12, datë 28.04.2009 të KRRT-së, Bashkia Kamëz dhe genplanit bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Planimetria e ambientit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi;
3. Periudha e dhënies me qira të përcaktohet në kontratën që do të lidhet ndërmjet subjektit dhe Bashkisë Kamëz, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 54, datë 05.02.2014 të Këshillit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar;

4. Ngarkohet “Drejtoria e Çështjeve Ligjore” për ndjekjen e procedurave të lidhjes së kontratës.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

